

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kredia rritet 14.3%, financimi i pasurive të paluajtshme në rekord/ Sejko u kërkon bankave kujdes
ADRESA	https://tpz.al/kredia-rritet-14-3-financimi-i-pasurive-te-paluajtshme-ne-rekord-sejko-u-kerkon-bankave-kujdes-i333095
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 15:34:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 15:21:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ea7ea3536dd98627c275aac7ae4cbf8e0edc51313cb85dae1f7435b38a0eaada
TEKSTI	271dbb3970e9de0006f1e02c7af983f5e02f64f857f767b17bdbb1eba310c487
PAMJA	2c4c66e45e4d396be26ac57713c1feb4d95f1ef1086864b54a31a70057786b68

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5856e0b0f25a41a6589e356d9081b7478d6cf90fdebb9357187ce24b17fc93b2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c11531ba0c325ce57cb42979570286028b15ce78f5f30478d991f53d7430dd86
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5856e0b0f25a41a6589e356d9081b7478d6cf90fdebb9357187ce24b17fc93b2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

17:08 Pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së, Kroacia del në mbështetje të Kosovës: Ishte viktimë e krimeve të Millosheviçit! • 13:56 "I padrejtë dhe i pamerituar"/ Vendimi i Ha

AKTUALITET, 16 SEPTEMBER 2026, 17:21

Kredia rritet 14.3%, financimi i pasurive të paluajtshme në rekord/ Sejko u kërkon bankave kujdes



TPZ



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, mbledhi këtë të mërkurë në një takim Ministren e Ekonomisë Delina Ibrahimaj, me drejtorët e përgjithshëm të bankave tregtare që operojnë në Shqipëri.

Takimi u zhvillua në kuadër të dialogut të vazhdueshëm të Bankës së Shqipërisë me sektorin bankar dhe u përqendrua në zhvillimet më të fundit në veprimtarinë bankare, ecurinë e kreditimit, tregun e pasurive të paluajtshme, si dhe në çështje me rëndësi për stabilitetin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit financiar. Vëmendje e veçantë gjatë diskutimeve iu kushtua ecurisë së kreditimit dhe rolit të sektorit bankar në financimin e ekonomisë. Të dhënat tregojnë se kreditimi vijon të ruajë ritme të larta rritjeje. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, kredia për sektorin privat u rrit me 14.3% në terma vjetorë, ndërsa raporti i saj ndaj PBB-së arriti në rreth 35%, niveli më i lartë i regjistruar në dekadën e fundit. Rritja e kreditimit ka qenë e pranishme si në segmentin e bizneseve, ashtu edhe në atë të individëve.

Guvernatori Sejko vlerësoi se këto zhvillime krijojnë premisa që kreditimi të vijojë të mbështesë konsumin dhe investimet në ekonomi. Në të njëjtën kohë, ai theksoi rëndësinë që rritja e kredisë të vijojë në mënyrë të kujdesshme dhe të shëndetshme, duke ruajtur standarde të përshtatshme kreditimi dhe administrimi të rrezikut.

Një tjetër çështje e diskutuar ishin edhe zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme dhe lidhja e tyre me aktivitetin kreditues. Diskutimet u fokusuan në ecurinë dhe dinamikën e këtij tregu, si dhe në zhvillimet e kreditimit për blerjen e banesave. Kredia hipotekare vijoi të shfaqë ritme të larta rritjeje, duke u zgjeruar me 16.1% në terma vjetorë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026. Ndërkohë, norma mesatare e interesit për kreditë hipotekare në lekë qëndroi në nivelin 3.9%.

Në këtë kuadër, Guvernatori Sejko u ndal edhe në masat makroprudenciale të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për financimin e blerjeve në tregun e pasurive të paluajtshme, përmes vendosjes së kufijve të sipërm për kredidhënien për pasuri të paluajtshme rezidenciale, bazuar në raportet "kredi ndaj vlerës së pronës" dhe "shërbimi i borxhit ndaj të ardhurave".

ide!

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Në Shqipërinë e sotme "revolucionari" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë
Nga Preç Zogaj

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tiera video](#)

Guvernatori vlerësoi se masat e marra kanë dhënë efektet e pritshme, duke kontribuar në një kreditim më të kujdesshëm dhe të balancuar të tregut të banesave. Ai theksoi se këto masa mbështesin zhvillimin e shëndetshëm të kreditimit dhe forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit bankar.

Në takim u diskutua gjithashtu ecuria e Programit të Financimit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm, të vënë në zbatim nga Banka e Shqipërisë për të përmirësuar aksesin në financim dhe për të ulur kostot e kredisë për këtë segment të rëndësishëm të ekonomisë. Nëpërmjet këtij programi, Banka e Shqipërisë ka vënë në dispozicion një fond prej 25 miliardë lekësh, i cili kanalizohet nëpërmjet bankave tregtare drejt bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe fermerëve. Programi krijon mundësi financimi me norma interesi të favorshme dhe është zgjatur deri në fund të vitit 2027. Deri më tani, në kuadër të këtij programi, Banka e Shqipërisë ka injektuar rreth 2.2 miliardë lekë likuiditet në sistemin bankar për financimin e bizneseve përfituese.

Guvernatori Sejko u bëri thirrje bankave tregtare që të angazhohen më aktivisht në zbatimin e programit dhe të rrisin kreditimin e bizneseve përfituese nëpërmjet tij, duke shfrytëzuar fondet dhe kushtet e favorshme që ai ofron. Ai theksoi se një përdorim më i gjerë i këtij instrumenti do të ndihmojë në përmirësimin e aksesit të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme në financim, në mbështetjen e investimeve dhe në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese të ekonomisë.

Në vijim, pjesëmarrësit diskutuan edhe çështje të lidhura me takimet e fundit të Misionit të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) në Shqipëri. Në këtë kuadër, u shkëmbyen vlerësime mbi çështjet e trajtuara gjatë misionit dhe angazhimin e sektorit bankar në këtë proces.

Në përfundim, Guvernatori Sejko vlerësoi bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave tregtare, duke nënvizuar rëndësinë e dialogut të hapur dhe të koordinimit për adresimin në kohë të sfidave dhe për ruajtjen e një sistemi bankar të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm, në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit.

AKTUALITET / 16 September 2026, 17:11

Çarje në tubacionin e Bogovës, Berati dhe Kuçova mbeten pa ujë prej disa orësh

AKTUALITET / 16 September 2026, 16:42

Inceneratori i Fierit, rinis gjykimi/ Apeli i GJKKO pranoi këtë të mërkurë kërkesën e SPAK

AKTUALITET / 16 September 2026, 16:21

Ina Rama në trupën që gjykon mandatin e Ols Dados, prokurorin që vetë ia propozoi Presidentit Topi?

AKTUALITET / 16 September 2026, 16:09

Seanca në Apelin e Posaçëm, Ilir Meta: Nuk kam munguar asnjëherë në gjyq

AKTUALITET / 16 September 2026, 14:12

Berisha apel demokratëve të distancuar. Ata që e shihnin vizën time amerikane si pengesë, i ftoj të rikthehen te partia! Nuk them për ata që janë aksionerë të qeverisë

AKTUALITET / 16 September 2026, 13:56

"I padrejtë dhe i pamerituar"/ Vendimi i Hagës për liderët e UÇK, Berisha: Në Serbi ka festë, por asgjë nuk e errëson Luftën Çlirimtare të Kosovës

AKTUALITET / 16 September 2026, 13:48

Reagimi zyrtar/ Prokuroria e Përgjithshme kundërshton projektligjin për pagat e magistratëve

AKTUALITET / 16 September 2026, 13:41

Zhgënjimi/ Gjykata Speciale dënoi Thaçin më shumë se Serbia, Haga i dha 25 vite, Millosheviçi e kishte dënuar me 10 vite në qeli

AKTUALITET / 16 September 2026, 13:33

Aktgjykimi ndaj liderëve të UÇK/ BE, apel për qetësi: Tregoni përmbajtje. Drejtësia duhet të lejohet të ndjekë rrjedhën e saj

AKTUALITET / 16 September 2026, 13:18

Ngërçi për pagat/ Disa gjykata veçojnë administratën nga gjyqtarët, zhbllkohet fondi për punonjësit

AKTUALITET / 16 September 2026, 13:11

Reagimet/ 81 vite burg për çlirimtarët e Kosovës, nga Begaj te Albulena Haxhiu, të

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:48

Kriza/ Rritja e ndjeshme e çmimit të karburanteve, ringrihet sërish Bordi i

[gjithë të zhgënjyer me vendimin e Hagës](#)

[Transparencës](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:43

[VIDEO/ Vijojnë tensionet jashtë gjykatës speciale në Hagë, protestuesit e revoltuar sulmojnë policinë holandeze. Shoqërohen disa prej tyre](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:38

[Operacioni/ Shiste kokainë dhe kanabis në lokalin ku punonte si kamerier, arrestohet 18-vjeçari në Elbasan](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:28

[VIDEO/ Shpërthen tensioni jashtë gjykatës speciale në Hagë, shqiptarët përplasen me policinë. Shoqërohen disa prej tyre](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:04

[Shpallen të pafajshëm për krime kundër njerëzimit, por liderët e UÇK-së dënohen nga Gjykata e Hagës me 81 vite burg](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 11:52

[Ish-krerët e UÇK-së dënohen rëndë nga "Specialja", reagon Rama: Marre!](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 11:01

[Trupi Gjykues i Gjykatës Speciale: Të paktën 303 persona u keqtrajtuuan nga anëtarë të UÇK-së](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:56

[Kryesuesi i Panelit të Trupit](#)

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:54

[Gjyqi në Hagë/ Rrëzohen](#)

Gjykues në Hagë: Kjo çështje gjyqësore nuk ka të bëjë me legjitimitetin e UÇK-së, por vetëm me përgjegjësi personale

akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj popullatës civile për krerët e UÇK-së

[KONTAKT](#)

[PRIVACY POLICY](#)

[COOKIES](#)

[NJOFTIME NGA TPZ.AL](#)



tpz.al

[AKTUALITET](#)

[SPORT](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.